



REPUBLIKA E KOSOVES	REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPTIONIT	ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	D.P.	Nr. Prot. 03/4014/11
Dep.	Bij. Prot.	Datum: 12.10.2011
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTE NË PRISHTINË / OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIŠTINU / MUNICIPAL COURT FOR MINOR OFFENCES IN PRISHTINA / 2011	PRIŠTINE	



Nr.regj.24888/11

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTE NË PRISHTINË**, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Gani Rexhë Mehmetaj nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6.parg.2 lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundervajtjet, me dt.14.10.2011 merrë ketë,

#### A K T V E N D I M

**I PANDEHURI:**Gani Rexhë Mehmetaj i lindur me 07.10.1955 në Dubovë K.Pejës,tani jeton në Rr”Shpetim Robaj”nr.21, i martuar,babë i 3 fëmijve, i gjendjes së mesme ekonomike,Fakultetin e shkencave politike të kryer,Drejtor i Kosovafilmit në Prishtinë.

#### Ë s h t ë p ë r g j e g j e s

Sepse si Drejtor i Kosovafilmt-në Prishtinë,nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korruptionit në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë i njohtuar se është përfshirë në listen e Zyrtarve të Ministrisë së Kulturës,Rinisë dhe Sporteve,të cilet janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë.

Me veprim të këtill ka kryer kundervajtje nga neni 6 pika.2.lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë:

#### D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **800 (tetëqind )** Euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formen e prerë. Në dobi të të hyrave gjyqësore të Kosovës,në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.

Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet në denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke ju llogaritur 15 EURO në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedures nuk ka pasur.Në emer të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EURO, në afat dhe xhirolllogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit,kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

#### A r s y e t i m

**Agjacioni Kundër Korruptionit në Prishtinë**,me kërkesën nr.0-3223/11 të parashtruar gjykatës me datën 19.07.2011 për inicimin e procedures kundërvajtëse kundër të pandehurit të permendor me lartë, për kundravajtjen e përshkuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata duke vepruar sipas kerkessës, ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse dhe në seance verbale ka ndegjuar të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaron. Është vertet se për vitin 2011,nuk e kam bërë deklarimin e pasurië pranë Agjencionit Antikorrupsion,mua askush nuk më ka lajmre se unë jam i obliguar që përë çdo vit ta bejë deklarimin e pasurisë.Kurse sa i përket Listës së Zyrtave të Ministris së Kulturës Rinisë dhe Sporteve,të cilët janë të obliguar që ta bejnë deklarimin e pasuris,drejtoria ku unë punoj është e ndarë fizikisht nga objekti i kësaj Ministrije,prandaj ka munguar informata.

2.

Për sqarimin edhe ma mirë të kësaj qështje gjykata ju drejtue Ministrisë së lartëcekur që ta informon se a ka qenë i pandehuri i njohtuar se duhet ta bënë deklarimin e pasurisë.

Ministria ja ka derguar gjykatës shkresën ku shifet se të gjith drejtorët, po edhe i pandehuri Gain Mehmetaj kanë qenë të informuar se janë të obliguar për shkak të funksionit që mbajn ta bejnë deklarimin e pasurisë.

Gjykata pas vlersimit të mbrojtjës së të pandehurit, provave të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresave tjera të lendës, erdhi në përfundim se i pandehuri e ka kryer kundervajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundervajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari e pati parasysh peshen e kundervajtjes, si dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe renduese.

Duke i marrë prasysh të gjitha këto vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me ketë gjobë mund të arrihet efekti pozitiv i sankzionimit.

Me sa u tha me lartë u vendos sin e dispozitiv te ketij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të parashtohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundervajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marries së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykatë.

#### **VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PRISHTINË.**

Gjyktari  
Murat Paçarada